

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtje të konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar mbi njoftimin për përqendrim të paraqitur nga HELLENIC ENERGY Holdings S.A. me seli të regjistruar në adresën Himaras 8A, Marusi, Athinë, Greqi, dorëzuar nëpërmjet Shoqërisë së Avokatëve Polenak, avokat Metodija Velkov nga Shkupi, në senacën e mbajtur më 17.04.2025, mori këtë

### AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin HELLENIC ENERGY Holdings S.A., me seli të regjistruar në adresën Himaras 8A, Marusi, Athinë, Greqi, ka qëllim të fitojë kontroll të pavarur direkt mbi ELPEDISON B.V., me seli të regjistruar në adresën Naritaveg 165, 1043 BV Amsterdam, Holandë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë të rëndësishme të tij, në veçanti si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës sipas nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë takse administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000 denarësh, si dhe për vendimin në shumë prej 30.000 denarësh, sipas tarifës numër 34 të Ligjit për taksa administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 si dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogari pagese 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

### Arsyetim

Në përputhje të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për mbrojtje të konkurrencës (në vijim: Ligji), më 26.03.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni) i është dorëzuar njoftim për përqendrim nga HELLENIC ENERGY Holdings S.A., me seli në adresën Himaras 8A, Marusi, Athinë, Greqi, me të cilin HELLENIC ENERGY Holdings S.A. fiton kontroll të pavarur mbi ELPEDISON B.V., me seli të regjistruar në adresën Naritaveg 165, 1043 BV Amsterdam, Holandë, dhe në mënyrë indirekte mbi ELPEDISON S.A. Fragkoklisias 6, Marusi, Atiki, Greqi, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni ka filluar shqyrtimin e Njoftimit me datën e marrjes së tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në njoftimin për përqendrim dhe shtojcat përkatëse ka konstatuar si vijon:

### **Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

HELLENIC ENERGY Holdings S.A. është grup që operon në sektorët e rafinerisë, furnizimit dhe tregtisë me karburant, energjisë së ripërtëritshme, si dhe në kërkim dhe prodhim të hidrokarbureve.

HELLENIC ENERGY Holdings S.A. është aktive në shumë sektorë, kryesisht në sektorin e energjetikës. Aktiviteti kryesor i grupit është rafineria, që operohet përmes shoqërisë së varur HELLENIC PETROLEUM S.A.

HELLENIC ENERGY Holdings S.A. ka një shoqëri të regjistruar të lidhur në Maqedoninë e Veriut:

- OKTA Rafineri nafte Shoqëri aksionare - Shkup, me seli të regjistruar në rrugën 1 nr. 25, Miladinovci, Ilinden, Maqedonia e Veriut, aktiviteti i regjistruar është tregtia me shumicë e karburanteve të ngurta, të lëngshme dhe gazi si dhe produkteve të ngjashme.

HELLENIC ENERGY Holdings S.A. gjithashtu ka një degë të regjistruar në Maqedoninë e Veriut:

- Ndërmarrja për tubacione nafte Selanik-Shkup-VARDAKS AD – Dega VARDAKS Shkup, me seli të regjistruar në rrugën Miladinovci nr. Instalacionet/OKTA p.f.-66 Miladinovci, Ilinden, Maqedonia e Veriut, me aktivitet të regjistruar transport me tubacione.

**ELPEDISON B.V.** është shoqëri holding. **ELPEDISON S.A.** është shoqëri e varur në pronësi të plotë të ELPEDISON B.V. ELPEDISON B.V. është vetëm shoqëri holding, e inkorporuar si shoqëri për qëllime të veçanta, për ushtrimin e kontrollit mbi ELPEDISON S.A.

**ELPEDISON S.A.** është shoqëri që operon kryesisht në Greqi në sektorët e prodhimit dhe furnizimit me shumicë të energjisë elektrike dhe tregun me pakicë të energjisë elektrike, si dhe në tregjet e furnizimit me gaz natyror me shumicë dhe pakicë.

ELPEDISON S.A. ka një shoqëri të regjistruar të lidhur në Maqedoninë e Veriut:

- Shoqëri për tregti dhe shërbime ELPEDISON POWER GENERATION SHPKNJ Shkup, me seli të regjistruar në rrugën Shën Kirili dhe Metodij nr. 48, Qendër, Shkup, Maqedonia e Veriut, aktiviteti i regjistruar tregtia me energji elektrike. ELPEDISON POWER GENERATION DOOEL Shkup ende nuk është subjekt aktiv biznesi.

Përveç ELPEDISON Shkup, ELPEDISON B.V. nuk ka shoqëri të tjera të regjistruara të lidhura apo degë në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pika 6 b) e Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të

njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ para Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**KRYETARE**

**М-р Малинка Силјановска Николиќ**